



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 21

Datë: 03. 04. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP;

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 19/2024
3. Aktivitetet e SKQZ
4. Aktivitetet e Zyrës

Raporti njoftues për pranimin e Formularëve për vazhdimin e regjistrimit, 31 mars 2024

5. Raport i Këshillave të KQZ

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit operacional të sigurisë, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Dizajnit të fletëvotimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vlerësimi i Qendrave të votimit nga KKZ-të për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për ID Bexha për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave;
5. Njoftim lidhur me materialet në Depo të KKZ në secilën komunë;

6. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Radoniqi** e hapi mbledhjen nr. 21 të KQZ-së e cila, për shkak të ndërprerjes së rrymës elektrike, u mbajt në objektin e Këshillit Gjyqësorë. Agjenda e takimit u miratua pa ndonjë vërejtje apo propozim me 10 vota të anëtarevë të pranishëm.

Në vazhdim, me 9 vota për dhe 1 kundër, u miratuar procesverbali nr. 19/2024.

2. Aktivitetet e SKQZ:

Burim Ahmetaj, drejtor i Sekretariatit tha se është përgatitur raporti i aktivitetit lidhur me informimin e KQZ-së për procesin e votimit për largimin e kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut, të datës 21 prill 2024. Sekretariati, ka përgatitur ftesën për Subjekte Politike për propozimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve dhe dhe KVV për Ekipet Mobile. Ftesa, do tu bëhet të gjitha Subjektet Politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendeve Komunale në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut, sipas komunave përkatëse.

Sipas planit të aktiviteteve për procesin e votimit dhe ftesës, nominimet duhet të dorëzohen në KKZ të komunës përkatëse, jo më vonë se me datë 8 prill 2024 në ora 16:00. Më datën 01.04.2024, është bërë kërkesa në departamentet e Agjencisë së Regjistrimit Civil për pajisjen me Ekstraktin e Tretë dhe të fundit për këtë proces të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave.

Në vazhdim, z. Ahmetaj tha se me datën 03.04.2024 nga dy departamentet kemi pritur ti pranojmë ekstraktet, me të dhënat e të gjithë shtetasve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët janë të moshës 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe personat që deri me datën 21 prill 2024, mbushin moshën 18 vjeç. Dhe, pas pranimit të ekstraktit të tretë do të bëhet krahasimi i të dhënave mes ekstraktit të parë, të dytë dhe të tretë dhe ndryshimet mes ekstrakteve do të aplikohen në Listën e votuesve, në makinën kërkuese.

Zbatimi i periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së ka filluar me datë 18.03.2024 dhe do të përfundojë me datë 05.04.2024. Deri me datën 02.04.2024 Sekretariati nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për kundërshtim të LV. Sipas rregullores 03/2024 - Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, Lista Preliminare e Votuesve bëhet publike në zyrat e KKZ, në formatin elektronik dhe në platformën elektronike.

Ahmetaj, e informoi KQZ-në se më 20.03.2024, zyrtarëve ekzekutiv të KKZ të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, ju është përcjellë Lista Preliminare e Votuesve (LPV) në formatin elektronik (pdf), dhe formulari i ankesës. LPV, është publikuar edhe në Makinën Kërkuese. Në Ueb Faqe të KQZ është publikuar formulari i ankesës dhe email adresa ku votuesit kanë pasur mundësi të dërgojnë ankesën. Deri me datën 02.04.2024 nuk kemi pranuar ankesë/kërkesë për kundërshtim të Listës Preliminare të Votuesve.

Gjithashtu, zbatimi i periudhës së regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ka filluar me datë 29.03.2024, dhe do të përfundojë me datë 03.04.2024. Shtetasit të cilët jetojnë jashtë Kosovës kanë mundësi të regjistrohen përmes platformës elektronike dhe përmes postës. Deri me datën 02.04.2024 përmes platformës elektronike divizioni i shërbimit votues ka pranuar dy (2) kërkesa për regjistrim, të cilat janë shqyrtuar dhe aprovuar.

Sekretariati, ka përgatitur edhe zbatimin e periudhës për ndërrimin e qendrës së votimit që ka filluar me datën 18.03.2024, dhe do të përfundojë me datën 03.04.2024. Janë pranuar 10 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit. Dy (2) kërkesa nga komuna e Zveçanit, dhe tetë (8) kërkesa nga komuna e Mitrovicës së Veriut. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe aprovuar.

Gordana Llaban, kur do të informohemi se sa votues kanë të katër komunat.

Burim Ahmetaj, tha se jemi në përpunim të të dhënave. Së shpejti...

3. Aktivitetet e Zyrës

Raporti njoftues për pranimin e Formularëve për vazhdimin e regjistrimit, 31 mars 2024:

Besnik Buzhala, tha se partitë e regjistruar deri më 31 mars, janë të obliguara që të raportojnë në zyrë formularin për vazhdimin e regjistrimit. Tabela, është dërguar dhe se 52 parti ishin të obliguara. 27 parti, e kanë dërguar formularin, 2 parti ende nuk e kanë dorëzuar. Këto dy parti, janë për rekomandim për çregjistrim: partia Ura dhe Forca e Diasporës.

Pas shqyrtimit nga anëtarët e KQZ, me 10 vota për çregjistrim këto dy parti.

4. Raport i Këshillave të KQZ

1. Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit operacional të sigurisë, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar draft – planin e votimit për siguri për votimin e 21 prillit. Plani parasheh masat, dhe plani është dërguar te ju.

Me 9 vota për, 1 abstenim u miratua plani operacional i sigurisë për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Dizajnit të fletëvotimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Gjithashtu, tha z. Elshani, KOZ ka shqyrtuar edhe dizajni dhe se këtu kemi sjellë ‘3 propozime – formulim të pyetjes’ lidhur me votimin, bashkë me dizajnin...

Me 7 vota për, 3 abstenim u përzgjedh propozimi i tretë, dhe u miratua ‘pyetja’ bashkë me dizajnin, për të dy gjuhët...

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vlerësimi i Qendrave të votimit nga KKZ-të për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe QV-të, dhe se është konstatuar se janë funksionale 44 QV ku mund të votohet. Sekretariati, ndërkohë ka rekomanduar edhe 4 QV që, do të jenë funksionale së shpejti.

Me 9 vota për, 1 abstenim u miratua raporti i Vlerësimit të Qendrave të votimit.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për ID Bexha për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave:

KOZ -i, ka shqyrtuar edhe specifikat e ID-ve. Z. Elshani, tha se do të prodhohen 750 ID-i për vëzhguesit, kryesuesit, këshillat e KVV etj.

Me 9 vota për, 1 abstenim u miratuan specifikat për ID Bexha për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave që, mbahet më 21 prill, 2024.

Të ndryshme!

Kreshnik Radoniqi, diskutoi rreth aplikimit për votim jashtë vendit, meqë është dita e fundit. Janë, vetëm 2 aplikime. Po e ngris si çështje, dhe a mundet me u shty afati...?

Burim Ahmetaj: Mundet për 1, e shumta 2 ditë por jo më shumë, sepse interferohen afatet, plani operacional...!

Në këtë pikë, diskutuan: Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Arianit Elshani dhe Sami Kurteshi.

Me 8 vota për, dhe 2 kundër u shty edhe për dy ditë aplikimi i votimit nga jashtë, deri më 5 prill.